



FTESË PËR PJESËMARRJE NË PANAIRIN “BLEJ SHQIP” 2016

Komuna e Prishtinës në bashkëpunim me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes në Republikën e Shqipërisë, organizon panairin “**Blej Shqip**” si një nismë që synon të bëjë reklamimin e prodhimit vendas nga të gjitha trevat shqiptare për të nxitur rritjen e konsumit të prodhimeve shqiptare si motori kryesor i zhvillimit ekonomik. Panairi do të zhvillohet për tri ditë rresht në qendër të qytetit të Prishtinës, gjatë ditëve të festës sonë kombëtare. Për shkak të faktit që panairi të ngjashëm me këtë janë mbajtur edhe në të kaluarën për të shënuar festën tonë kombëtare, tashmë në Prishtinë ky lloj aktiviteti është kthyer në një traditë. Duke u nisur edhe nga pozicionimi i panairit në qendër të qytetit, ai vizitohet nga dhjetëra mijëra qytetarë shqiptarë e të huaj.

Në vijim gjendet informacion mbi detajet e këtij aktiviteti:

Vendi ku do të mbahet panairi : Prishtinë,
Bulevardi “Nëna Terezë” dhe Sheshi “Zahir Pajazi”

<i>Kohëzgjatja e panairit:</i>	3 ditë
<i>Datat:</i>	28, 29 dhe 30 nëntor 2016
<i>Koha:</i>	10:00 – 24:00
<i>Hapësira:</i>	Dy prodhues në një tezgë

Pjesëmarrja është pa pagesë.

Numri i bizneseve pjesëmarrëse është i limituar.



Për më shumë informacion dhe për të rezervuar një hapësirë reklamuese ju lutemi të kontaktoni:

Komunën e Prishtinës në e-mailin panairblejshqip@gmail.com

Afati për rezervimin e hapësirës reklamuese është prej:

17.11.2016-23.11.2016

Për informata shtesë kontaktoni: 0037744375753

Mirëpresim pjesëmarrjen tuaj